



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR

**PËRMBAJTJEN E RAPORTIT VJETOR QË PUBLIKOHET NGA SHOQËRITË E
SIGURIMIT DHE RISIGURIMIT**

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 110, datë 26.10.2015

Ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 170, datë 31.10.2016

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave minimale për përmbajtjen e raportit vjetor që publikohet nga shoqëria e sigurimit dhe risigurimit.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 128, pika 2, të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të konsumatorit dhe palëve të tjera të interesit, nëpërmjet rritjes së transparencës në tregun e sigurimeve, si dhe për të nxitur qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e tregut të sigurimeve.

Neni 4

Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.
2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termi:

“Publikim” është vënia në dispozicion e informacionit për të gjitha kategoritë e përdoruesve: publikun, pjesëmarrësit e tregut, investitorët, punonjësit, përfituesit, të siguarit, qeveritë dhe organizmat e tjerë sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 5

Parimet e publikimit të raportit vjetor

Raporti vjetor që publikohet nga shoqëria e sigurimit dhe e risigurimit duhet të përmbajë informacion, i cili hartohet duke u bazuar në parimet e:

- Plotësisë;
- Materialitetit;
- Qartësisë në shprehje;
- Thjeshtësisë;
- Përshtatshmërisë në vënien në dispozicion dhe përdorim të raportit.

***Neni 6**

Përmbajtja dhe publikimi i raportit vjetor

1. Raporti vjetor i shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit përmban një analizë të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit në raport me përmbushjen e funksioneve dhe detyrave ligjore të saj gjatë një viti.
2. Shoqëria e sigurimit publikon në mënyrë të përshtatshme informacion të detajuar në një mënyrë që është e kuptueshme për pjesëmarrësit e tregut, mbi profilin e tyre, qeverisjen dhe kontrollin, pozicionin financiar, performancën teknike dhe rreziqet ndaj të cilave ato ekspozohen.

3. Shoqëria e sigurimit përgatit dhe publikon raportin e saj vjetor, i cili përmban minimalisht:
- a) Strukturën qeverisëse të shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit;
 - b) Pasqyrat financiare të përgatitura sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
 - c) Opinionin e shoqërisë audituese;
 - d) Raportin vjetor të auditimit të brendshëm;
 - e) Pjesëmarrjet e shoqërisë në kapitalin e shoqërive të tjera;
 - f) Listën e aksionareve të shoqërisë së sigurimit me pjesëmarrje influencuese të kapitalit dhe të dhëna për pjesëmarrjen e tyre;
 - g) Listën e administratorëve të shoqërisë së sigurimit, si edhe të atyre që kanë pjesëmarrje influencuese në kapitalin e shoqërisë së sigurimit dhe të dhëna mbi pjesëmarrjet e tyre;
 - h) Përshkrimin e përmbledhur të parimeve të monitorimit, administrimit dhe kontrollit të rrezikut që ndërmerr shoqëria e sigurimit dhe risigurimit, si dhe instrumentet e përdorura për kufizimin e tij sipas Rregullores 18, datë 28.04.2015 “Për rregullat e organizimit të sistemit të administrimit të rrezikut në shoqërinë e sigurimit”, të Autoritetit;
 - i) Objektivat e shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit për vitin pasardhës;
 - j) Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit;
 - k) Treguesi i likuiditetit;
 - l) Treguesi i aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike.

Neni 7

Forma e publikimit të raportit vjetor

1. Raporti vjetor publikohet në formë të printuar dhe elektronike.
2. Raporti vjetor në formë të printuar është i disponueshëm në mjedise të përdorshme nga publiku, në zyrat qendrore dhe në të gjitha degët dhe agjencitë e tyre.
3. Raporti vjetor në formë elektronike publikohet në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë së sigurimit, që në faqen e parë të saj, e cila punon jo më pak se 90 për qind të vitit.
4. Shoqëritë e sigurimit publikojnë informacionin në gjuhën shqipe dhe mbi baza vullnetare edhe në gjuhë të huaj.
5. Shoqëritë e sigurimit shënojnë datën në të cilën publikojnë raportin dhe datën kur plotësojnë dhe/ose korrigjojnë informacionin e publikuar më parë, në rastin e publikimit të një informacioni shtesë apo plotësues, që i referohet të njëjtit informacion.
6. Autoriteti publikon në linke të veçanta raporte vjetore të shoqërive të sigurimit si edhe linkun me QKR.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.